




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe 64.2 Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 02.09.2024, nxjerr këtë:



VENDIM

Për Miratimin e Planit të Buxhetit për Punëtorinë e Përbashkët për Shkëmbim të Praktikave Zgjedhore dhe Forcim të Bashkëpunimit mes KQZ së Kosovës dhe KQZ së Shqipërisë

- I. Miratohet Plani i të buxhetit, për punëtorinë e përbashkët për shkëmbim të praktikave zgjedhore dhe forcim të bashkëpunimit mes KQZ së Kosovës dhe KQZ së Shqipërisë.
- II. Plani i Buxhetit si në pikën I është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 02.09.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Plani i Buxhetit

Organizimin i takimeve dhe punetorisë në mes KQZ e
Kosoves dhe Shqiperisë

Buxheti i Projektit


Përshkrimi i shpenzimeve	Shuma (EUR)
Transporti:	
Transporti i organizuar për vizita (autobus)	500 Euro
Bileta (Tiketa) për parking dhe vizita (nëse është e nevojshme)	100 Euro
Akomodimi dhe Ushqimi:	
Akomodimi për delegacionin e KQZ Shqipëri	2,000 Euro
Dreka dhe Darka Pune	4,000 Euro
Hapësirat dhe Pajisjet:	
Qiraja e sallave të takimeve	1,000 Euro
Pajisjet teknologjike, (projektor, zërimi, mikroфона)	2,000 Euro
Materialet reklamuese:	
Materialet reklamuese	600 Euro
Dhurata	500 Euro
Gjithsejt	10,700 Euro



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe 64.2 Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 02.09.2024, nxjerr këtë:



VENDIM

Për Miratimin e Projektit dhe Agjendës për Punëtorinë e Përbashkët për Shkëmbim të Praktikave Zgjedhore dhe Forcim të Bashkëpunimit mes KQZ së Kosovës dhe KQZ së Shqipërisë

- I. Miratohet Projekti dhe agjenda, për punëtorinë e përbashkët për shkëmbim të praktikave zgjedhore dhe forcim të bashkëpunimit mes KQZ së Kosovës dhe KQZ së Shqipërisë.
- II. Projekti dhe agjenda si në pikën I, janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 02.09.2024

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



AGJENDA

DATË

25, 26 dhe 27 shtator 2024

VENDI

PRISHTINË DHE PRIZREN

TEMA

PUNËTORI E PËRBASHKËT PËR SHKËMBIM TË PRAKTIKAVE ZGJEDHORE
DHE FORCIM TË BASHKËPUNIMIT MES DY KOZ-ve

DITA E PARË, 25 SHTATOR 2024

VENDI

PRISHTINË

13:00

ARRITJA E KQZ-së SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE AKOMODIMI NË HOTEL

VIZITË E KQZ-SË SË SHQIPËRISË NË KQZ-NË E KOSOVËS

15:00

Takimi në fillim është i hapur për media. Kryesuesi i KQZ-së së Kosovës, z. Kreshnik Radoniqi dhe Komisioneri Shtetëror, z. Ilirjan Celibashi, i adresohen mediave dhe mund të pranojnë pyetje nga përfaqësuesit e tyre. Në takim marrin pjesë anëtarët e KQZ-së së Kosovës dhe delegacioni i KQZ-së së Shqipërisë.

16:00 – 18:00

DREKË/DARKË E PËRBASHKËT MES DY KQZ-ve

DITA E DYTË, 26 SHTATOR 2024	VENDI
	PRISHTINË

TAKIM ME PRESIDENTEN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

09:00 – 10:00 Mediat mund të marrin pamje në fillim të takimit. Njoftim për media nga Presidenca e Republikës së Kosovës lidhur me mbajtjen e takimit. *(Vendoset nga Presidenca).*

HYRJE

10:30 – 10:45 **Fjalë përshëndetëse:**

- Z. Kreshnik Radoniqi – Kryesues i KQZ-së, Kosovë
- Z. Ilirjan Celibashi – Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Shqipëri

Moderator:
Valmir Elezi – Zëdhënës i KQZ-së

10:45 – 11:00 INFORMIMI DHE EDUKIMI I VOTUESVE PARA DHE GJATË PROCESIT ZGJEDHOR

Prezantim nga KQZ e Kosovës

11:00 – 11:15 INFORMIMI DHE EDUKIMI I VOTUESVE PARA DHE GJATË PROCESIT ZGJEDHOR

Prezantim nga KQZ e Shqipërisë

11:15 – 11:30 DISKUTIME

11:30 – 11:45 PAUZË PËR KAFE

11:45 – 12:00 IDENTIFIKIMI ELEKTRONIK I VOTUESVE / TEKNOLOGJIA NË ZGJEDHJE

Prezantim nga KQZ e Kosovës

12:00 – 12:15 IDENTIFIKIMI ELEKTRONIK I VOTUESVE / TEKNOLOGJIA NË ZGJEDHJE

Prezantim nga KQZ e Shqipërisë

12:15 – 12:45 DISKUTIME DHE PËRMBYLLJE

13:00 – 14:30 DREKË

15:00 – 18:00 VIZITË NË KOMPLEKSIN MEMORIAL “ADEM JASHARI” NË PREKAZ (SKËNDERAJ).

18:00 – 21:00 KTHIMI NË PRISHTINË DHE DARKË

DITA E TRETË, 27 SHTATOR 2024		VENDI
		PRIZREN
Pjesa e parë		
VOTIMI JASHTË VENDIT		
11:00 – 11:15	Prezantim nga KQZ e Kosovës	
11:15 – 11:30	Prezantim nga KQZ e Shqipërisë	
11:30 – 12:00	DISKUTIME	
DISKUTIME RAPORTIMI DIGJITAL I FINANCAVE TË PARTIVE POLITIKE		
12:00 – 12:15	Prezantim nga KQZ e Kosovës	
DISKUTIME RAPORTIMI DIGJITAL I FINANCAVE TË PARTIVE POLITIKE		
12:15 – 12:30	Prezantim nga KQZ e Shqipërisë	
12:30 – 13:00	DISKUTIME DHE PËRMBYLLJE E PUNËTORISË	
NËNSHKRIMI I MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT		
13:30	Ceremonia është e hapur për media. Kryesuesi i KQZ-së së Kosovës, z. Kreshnik Radoniqi dhe Komisioneri Shtetëror, z. Ilirjan Celibashi, i adresohen mediave dhe mund të pranojnë pyetje nga përfaqësuesit e tyre.	
14:00 – 15:30	DREKË E PËRBASHKËT MES DY KQZ-ve	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Projekti

Organizimin i takimeve dhe punetorisë në mes KQZ e
Kosoves dhe Shqiperisë

Prishtinë, shtator 2024

Përmbajtja

Hyrje	3
1. Objektivat e Takimit	3
2. Qëllimi	3
3. Agjenda e Takimit	4
4. Pjesëmarrësit	5
5. Lokacioni	5
6. Shpenzimet:	5
7. Buxheti i Projektit	6
9. Pika të veçanta për diskutim:	7
10. Plani i veprimit për organizimin e Takimit mes dy KQZ-ve	7

Hyrje

Projekti për organizimin e takimit mes Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ të Republikës së Kosovës dhe Shqipërisë synon organizimin e një takimi të nivelit të lartë dhe teknik mes KQZ-ve të dy vendeve, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përmirësimin e proceseve zgjedhore në të dy vendet. Duke marrë parasysh rëndësinë e zgjedhjeve të drejta, transparente dhe të besueshme për demokracinë, ky takim do të shërbejë si një platformë për shkëmbimin e përvojave, sfidave dhe praktikave më të mira.

Në kontekstin e zhvillimeve të fundit teknologjike, nevoja për të ndarë eksperiencat dhe për të mësuar nga njëri-tjetri është shumë e rëndësishme. Takimi synon të adresojë këto nevoja përmes diskutimeve mbi temat kyçe të menaxhimit të proceseve zgjedhore, duke përfshirë integritetin zgjedhor, transparencën, teknologjinë në zgjedhje, dhe rolin e institucioneve në mbikëqyrjen e proceseve zgjedhore.

Ky projekt do të krijojë një bazë për një bashkëpunim të vazhdueshëm mes KQZ-ve të të dy vendeve, duke forcuar kështu strukturat institucionale dhe duke kontribuar në zhvillimin e demokracisë në rajon. Nga ky takim pritet që rezultatet e këtij takimi të ndihmojnë në harmonizimin e politikave dhe praktikave zgjedhore, duke sjellë përfitime për proceset zgjedhore në Kosovë dhe Shqipëri.

Me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe sfidave nga proceset e kaluara zgjedhore, KQZ e Kosovës dhe Shqipërisë do të organizohet takim pune i përbashkët. Temat e takimeve/punëtorisë janë por nuk kufizohen në:

a) përdorimi i teknologjise dhe kamerave ne qendrat komunale te numerimit, dhe vendvotim, b) identifikimi elektronik i votuesve c) raportimi digjital i finanancave të partive politike d) ntelegjenca artificiale ne procesin e zgjedhjeve, votimin jashte vendit etj.

1. Objektivat e Takimit

- Diskutimi mbi sfidat e përbashkëta dhe identifikimi i zgjidhjeve të mundshme.
- Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira në menaxhimin e proceseve zgjedhore.
- Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit mes dy institucioneve në lidhje me çështjet zgjedhore.

2. Qëllimi

Qëllimi i takimit mes KQZ të Kosovës dhe Shqipërisë synon forcimin e bashkëpunimit, demokracisë dhe besimin e qytetarëve në proceset zgjedhore në të dy vendet.përfshinë:

2.1 Shkëmbimi i Përvojave dhe Praktikave të Mira: Në këtë takim synohet të shkëmbehen përvojat dhe praktikat më të mira në menaxhimin e proceseve zgjedhore, duke përfshirë organizimin e zgjedhjeve, Kontrollin e Financave të Partive Politike, përdorimin e teknologjisë në procesin zgjedhor, trajtimin e ankesave, rezultatet e zgjedhjeve, sigurimin e transparencës etj.

2.2 Përmirësimi i Procesit Zgjedhor: Diskutime për sfidat dhe problemet që janë hasur gjatë proceseve zgjedhore dhe identifikimi i mënyrave për të përmirësuar procesin zgjedhor në të dy vendet.

2.3 Bashkëpunimi dhe Koordinimi Ndërkombëtar: Nxitja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet dy institucioneve për çështje të përbashkëta në kuadër të organizatave të asociuara, veçanërisht në rastet kur ka nevojë për përkrahje ose ndërhyrje të përbashkët.

2.4 Sigurimi i Zgjedhjeve të Drejta dhe Transparente: Diskutime mbi metodat për të rritur integritetin dhe transparencën e zgjedhjeve, duke përfshirë përdorimin e teknologjive të reja dhe standardeve ndërkombëtare.

2.5 Krijimi i një Memorandumi Bashkëpunimi: Nënshkrimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi që do të përshkruajë angazhimet dhe përgjegjësitë e secilit institucion për të mbështetur dhe përmirësuar proceset zgjedhore.

2.6 Forcimi i Kapaciteteve Institucionale: Shkëmbimi i përvojave, njohurive dhe trajnimeve për të përmirësuar kapacitetet e stafit të KQZ-së në të dy vendet.

3. Agjenda e Takimit

Agjenda e takimit është e ndarë në tre ditë, të cilat janë të kombinuara me takime pune, vizita nëpër vende të ndryshme brenda Kosovës, dreka dhe darka pune, diskutime gjatë takimit të punës, nënshkrim të marrëveshjes së bashkëpunimit etj. Në ditën e dytë parashihet edhe një takim i Titullarëve të dy Institucioneve me Presidenten e Kosovës e cila mbetet të konfirmohet nga Presidenca,

- **Dita 1:**
 - Takimi në KQZ,
 - Darkë pune,
- **Dita 2:**
 - Takimi me Presidneten e Republikës së Kosovës,
 - Hapja zyrtare dhe prezantimi i delegacioneve.
 - Prezantime mbi sistemet zgjedhore në Kosovë dhe Shqipëri.
 - Diskutime mbi sfidat kryesore të zgjedhjeve të fundit.
 - Sesion mbi inovacionet teknologjike në proceset zgjedhore.
 - Diskutime mbi financimin dhe transparencën e zgjedhjeve.
 - Vizita në Prekaz,

- Drekë dhe darkë pune,
- **Dita 3:**
 - Vizita në Kompleksin Lidhjes së Prizrenit,
 - Diskutime mbi çështje specifike.
 - Nënshkrimi i një memorandumi bashkëpunimi.
 - Mbyllja e takimit dhe diskutimet për hapat e mëtejshëm.
 - Drekë pune,

4. Pjesëmarrësit

- Delegacionet e KQZ-së së Kosovës dhe Shqipërisë: 10 zyrtarë nga Delegacioni i KQZ së Shqipërisë dhe 20 nga KQZ e Kosovës.
- Përfaqësues nga organizatat ndërkombëtare që mbështesin proceset zgjedhore?

5. Lokacioni

Takimet sipas draft - agjendës planifikohet të mbahen në lokacione të ndryshme. Akomodimi i delegacionit nga KQZ e Shqipërisë do të bëhet në njërin nga Hotelet në Prishtinë i cili ka vende të disponueshme për dy (2) netë në datat 25 dhe 26 shtator 2024.

Në ditën e parë do të jetë takimi Mirëseardhës i cili planifikohet të mbahet në ambientet e KQZ dhe do të pasohet me një darkë të përbashkët pune mes dy KQZ-ve në një ambient të përshtatshëm në afërsi të Prishtinës,

Në ditën e dytë, takimi me Presidneten e Republikës së Kosovës planifikohet të zhvillohet në Presidencë ndërsa drekë pune dhe punëtorja do të organizohen në ambientet e hotelit në të cilin janë akomoduar delegacioni i KQZ të Shqipërisë. Vizita në Kompleksin Memorial Adem Jashari në Prekaz do të organizohet me Transport të organizuar (Autobus) dhe në fund të ditës së dytë darkë pune do të jetë e organizuar jashtë Prishtinës.

Në ditën e tretë takimi do të organizohet në Qytetin e Prizrenit ku do të kete vizitë në Kompleksin e Lidhjes së Prizrenit ndërsa takimi do të organizohen në ambient të përshtatshëm për punëtorin në qytetin e Prizrenit përfshirë edhe drekë punë me çrast edhe përmbillet takimi mes dy KQZ-ve.

6. Shpenzimet:

KQZ si nikoqir të takimit të përbashkët do të mbulojë shpenzimet e akomodimit të Delegacionit nga KQZ e Shqipërisë, shpenzimet e drekave dhe darkave të punës mes dy KQZ-ve, shpenzimet e transportit brenda Kosovës, materialet reklamuese për takimet, dhuratat dhe shpenzime tjera për organizimin e takimit.

6.1 Transporti

- Transportin e organizuar (Autobus) për pjesëmarrësit në takim të përbashkët nga Prishtina në Komplexin Memorial “Adem Jashai” në Prekaz dhe kthimin,
- Shpenzimet e biletave (tiketave) gjatë vizitave dhe biletat e parkingut (nëse nevojitet).

6.2 Akomodimi dhe ushqimi:

- Shpenzimet e akomodimit në hotelit për delegacionin e KQZ së Shqipërisë.
- Dreka dhe darka pune për pjesëmarrësit.

6.3 Hapësirat dhe pajisjet:

- Qiraja e sallave të takimeve sipas lokacioneve.
- Pajisje për prezantime si projektorë, mikrofonë, zërimi dhe pajisje tjera teknike.

6.4 Materiale:

- Printimi i materialeve të takimit (agjenda, raportet, prezantimet).
- Përgatitja e dosjeve për pjesëmarrësit.
- Materiale promovuese (dhurata) për delegacionin e KQZ të Shqipërisë,
- Materiale reklamuese për takim,

6.5 Shpenzime të tjera:

- Shpenzime Logjistike, për përkthim simultan nëse është e nevojshme.
- Shpenzime për materiale reklamuese dhe Marrëdhënie me Publikun (PR).

7. Buxheti i Projektit

Përshkrimi i shpenzimeve	Shuma (EUR)
Transporti:	
Transporti i organizuar për vizita (autobus)	500 Euro
Bileta (Tiketa) për parking dhe vizita (nëse është e nevojshme)	100 Euro
Akomodimi dhe Ushqimi:	
Akomodimi për delegacionin e KQZ Shqipëri	2,000 Euro
Dreka dhe Darka Pune	4,000 Euro
Hapësirat dhe Pajisjet:	
Qiraja e sallave të takimeve	1,000 Euro
Pajisjet teknologjike, (projektor, zërimi, mikrofona)	2,000 Euro
Materialet reklamuese:	
Materialet reklamuese	600 Euro
Dhurata	500 Euro
Gjithsejt	10,700 Euro

8. Rezultatet e Pritshme:

- Përmirësimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet KQZ-ve të Kosovës dhe Shqipërisë.
- Rritja e cilësisë dhe transparencës së proceseve zgjedhore në të dy vendet.
- Zhvillimi i një plani veprimi për bashkëpunim të mëtejshëm dhe trajnime të përbashkëta.

9. Pika të veçanta për diskutim:

- Zbatimi i vendimeve të marra gjatë takimit.
- Planifikimi i takimeve të ardhshme dhe bashkëpunimeve të vazhdueshme.

10. Plani i veprimit për organizimin e Takimit mes dy KQZ-ve

- Planifikimi i detajuar: 1 muaj para takimit.
- Organizimi i logjistikës: 2 javë para takimit.
- Materialet reklamuese dhe dhuratat: 1 javë para takimit
- Rezervimet për akomodim, sallë takimesh, dreka, darka: 1 muaj para takimit
- Dërgimi i ftesave: 1 muaj para takimit,
- Realizimi i takimit: 3 ditë.

Bashkangjitur:


1. Agjenda e takimit mes KQZ të Kosovës dhe Shqipërisë
2. Plani i veprimit për organizimin e Takimit mes dy KQZ-ve



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe 64.2 Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 02.09.2024, nxjerr këtë:



VENDIM

Për Miratimin e Agjendës për Punëtorinë “Mësimet e Nxjerra nga Simulimi i Procesit Zgjedhor”

- I. Miratohet agjenda për punëtorinë “Mësimet e Nxjerra nga Simulimi i Procesit Zgjedhor”.
- II. Agjenda si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 02.09.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Agjenda – Punëtori për mësimet e nxjerra nga simulimi i procesit zgjedhor

Vendi: Prishtina Internacional Hotel

Data: 04.09. 2024

09:30 - 09:40 | Mirëseardhja dhe prezantimi i punëtorisë

- Fjalët hyrëse
- Prezantimi nga moderatori i punëtorisë

09:40 - 10:25 | Prezantimi i gjetjeve të simulimit të zgjedhjeve

- Votimi dhe numërimi
- Qendra Komunal e Numërimit
- Qendra e Numërimit dhe Rezultateve
- Softueri i Zgjedhjeve

10:25 - 11:20 | Diskutim

11:20 - 11:35 | Pushim për Kafe

11:35 - 12:00 | Rekomandimet dhe zhvillimi i planit të veprimit

- Zhvillimi i rekomandimeve të zbatueshme
- Caktimi i përgjegjësive për veprimet pasuese

12:00 - 12:30 | Fjalët përfundimtare dhe Hapat e mëtejshëm

- Përmbledhje e pikave kryesore


12:30 | Dreka



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 nenin 64 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 02.09.2024, nxjerr këtë:



VENDIM

Për Miratimin e Rekomandim të Sekretariatit për aprovimin e aktivitetit për përkrahje nga Misioni i OSBE në Kosovës lidhur me avancimin e infrastrukturës së TI-së në KQZ

- I. Miratohet e rekomandimi i Sekretariatit për aprovimin e aktivitetit për përkrahje nga Misioni i OSBE në Kosovës lidhur me avancimin e infrastrukturës së TI-së në KQZ.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 02.09.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniq

